



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 09 mars 2012  
Nr. ref.: RK199/12

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 51/10

Parashtrues

**Ljubiša Živić**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e z. Goran Zdravkovićit anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si përfaqësues të komunitetit serb**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Ljubiša Živić, nga Graçanica, Kryetar i Lidhjes së Socialdemokratëve të Pavarur.

## **Pala kundërshtare**

2. Pala kundërshtare është Presidenti i Republikës së Kosovës.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e z. Goran Zdravković anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si përfaqësues i komunitetit serb.

## **Shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë**

4. Parashtruesi i kërkesës nuk e ka specifikuar se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë pretendohet t'i jenë cenuar.

## **Baza juridike**

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Ankesa e parashtruesit të kërkesës**

6. Më 29 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, me të cilën pretendon se Presidenti i Republikës së Kosovës e ka shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës me emërimin e z. Goran Zdravkovićit anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si përfaqësues të komunitetit serb.
7. Më 28 tetor 2010, parashtruesi i kërkesës parashtrroi një kërkesë tjetër në Gjykatën Kushtetuese, me të cilën kërkon anulimin e Vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e z. Goran Zdravković dhe kthimin e z. Sinisha Zhiviç në pozitën e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si përfaqësues të komunitetit serb.

## **Procedura në Gjykatë**

8. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 29 qershor 2010.
9. Me urdhër të Kryetarit të datës 9 korrik 2010, gjyqtarja Gjyljeta Mushkolaj u emërua Gjyqtar Raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari e emëroi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Kadri Kryeziu.
10. Gjykata mbajti këshillime dhe e shqyrtoi kërkesën më 21 shkurt 2011.

## **Komentet e palës kundërshtare**

11. Më 5 korrik 2010, Presidentit të Republikës së Kosovës i është dërguar njoftimi për regjistrimin e lëndës dhe kërkesa për përgjigje. Më 2 gusht 2010, Presidenti i Republikës së Kosovës, përmes juristëve të tij të caktuar në mënyrën e duhur, i dërgoi përgjigje Gjykatës.

## **Përmbledhja e fakteve**

12. Më 4 korrik 2008, Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu, kërkoi nga përfaqësuesit e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare dhe nga përfaqësuesit e komuniteteve pakicë t'i dërgonin propozimet e tyre për përfaqësues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Më 4 korrik 2008, Presidenti i Republikës së Kosovës, po ashtu, kërkoi nga Partia Liberale Serbe, partia më e madhe politike që përfaqëson komunitetin serb në Kuvendin e Kosovës, që të dërgonte propozimin e saj për emërim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
13. Më 14 korrik 2008, z. Bojan Stojanović, kryetar i grupit parlamentar të Partisë Liberale Serbe, i dërgoi letër Presidentit të Republikës së Kosovës me të cilën propozonte z. Goran Zdravković për anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
14. Presidenti i Republikës së Kosovës, më 15 korrik 2008, e emëroi z. Goran Zdravković anëtar të KQZ-së si përfaqësues të komunitetit serb. Vendimi i Presidentit hyri në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.
15. Më 19 korrik 2008, z. Goran Zdravković e dha betimin para Presidentit dhe u bë zyrtarisht anëtar i KQZ-së.
16. Parashtruesi i kërkesës ankohet se Presidenti i Republikës së Kosovës ka bërë shkelje të Kushtetutës dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës duke emëruar z. Goran Zdravković anëtar të Komisionit Qendror Zgjedhor. Sipas parashtruesit të kërkesës, z. Goran Zdravković nuk i plotëson kushtet e parapara me ligj për atë pozitë, sa i përket kualifikimit.
17. Në kërkesën e tij të dytë drejtuar Gjykatës Kushtetuese më 28 tetor 2010, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të anulojë Vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe të zëvendësojë z. Goran Zdravković me z. Sinisha Zhiviç, i cili e kishte mbajtur më herët pozitën e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me vendimin e z. Joachim Rucker, Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2007/25, të datës 29 gusht 2008. Sipas parashtruesit të kërkesës, z. Sinisha Zhiviç i janë cenuar të drejtat me Vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e z. Goran Zdravković anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pa e njoftuar z. Sinisha Zhiviç për zëvendësimin e tij.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

18. Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligjin dhe me Rregulloren e punës të Gjykatës.
19. Gjykata vëren se neni 49 i Ligjit parashihet se kërkesa është dashur të dorëzohet brenda afatit prej katër (4) muajsh nga vendimi i fundit në këtë rast. Neni 49 përcakton si në vijim:
 

*“Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.*
20. Kur ky afat prej katër muajsh ka të bëjë me periudhën para hyrjes në fuqi të Ligjit. Neni 56 i Ligjit parashikon që “afati fillon të llogaritet në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji”. Ligji ka hyrë në fuqi më 15 janar 2009, në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

21. Vendimi i kontestuar i Presidentit të Republikës së Kosovës ishte nënshkruar më 15 korrik 2008, dhe ishte bërë publik në të njëjtën ditë. Anëtari i emëruar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me të njëjtin Vendim të Presidentit, e dha betimin para Presidentit të Republikës më 19 gusht 2008. Prandaj, afati për dorëzimin e kërkesës në Gjykatë ka kaluar më 15 maj 2009, ndërsa parashtuesi e ka parashtuar kërkesën më 29 qershor 2010. Rrjedhimisht, kërkesa është e paafatshme, në bazë të nenit të lartpërmendur të Ligjit.
22. Edhe sikur kërkesa të ishte dorëzuar brenda afatit, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës, *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”*, ndërsa neni 113.7 i Kushtetutës parasheh që, *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*.
23. Është e vërtetë se vendimet e Presidentit të Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me emërimin e individëve janë vendime të autoriteteve publike. Ato kanë të bëjnë me një ose më shumë të adresuar specifike, dhe duhet të konsiderohen si vendime që prekin të drejtat dhe liritë individuale të individëve të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, ato mund të jenë objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë, pra, ndaj tyre mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën Kushtetuese.
24. Sidoqoftë, ashtu siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit, parashtuesi nuk ka paraqitur prova dhe nuk ka argumentuar pohimin se atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë individuale me vendimin e Kuvendit. Në bazë të Kushtetutës, viktimë konsiderohet personi fizik ose juridik (shih rastin Universiteti AAB-RIINVEST SH. P. K, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti nr. KI. 41/09) të drejtat kushtetuese të të cilit preken personalisht ose drejtpërdrejt nga masat apo aktet e autoriteteve publike. Personi i cili nuk është prekur në këtë mënyrë, nuk e ka statusin e viktimës pasi që Kushtetuta nuk parasheh *actio popularis*. Me fjalë të tjera, një parashtues i kërkesës nuk mund të ankohet në abstrakt ndaj masave të autoriteteve publike të cilat nuk janë zbatuar personalisht ndaj tij, siç është ky rast në këtë Gjykatë. Rrjedhimisht, kërkesa hedhet poshtë, po ashtu, si qartazi e pabazuar.

#### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në bazë të nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, njëzëri

#### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Sekretariati do t’ua komunikojë vendimin palëve dhe të njëjtin do ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gjyljeta Mushkolaj



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani